


**SHOQËRIA TREGTARE  
"ARDI-2M" SHPK  
TIRANË**

---

**VENDIM NR. 02 datë 26. 11. 2005  
I ORTAKUT TË VETËM  
TË SHOQËRISË TREGTARE  
"ARDI-2M" SHPK**



Në Tiranë, sot në datën 26 muaji Nentor, 2005, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "ARDI-2M" SHPK, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë me Rezervat dhe Fitimet e Pashpërndara, të datës 21.11.2005 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. Sabah SHETA, pasi u njoh me rendin e ditës;

**V Ë R E N S E**

Shoqëria Tregtare "ARDI-2M" SHPK, është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 27592 datë 17. 04. 2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ortak i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Sabah SHETA. Kapitali themeltar i nënshkruar i kësaj shoqërie është 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Kështu, z. Sabah SHETA, zotëron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, i barabartë ky me 100 (njëqind) kuota me vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 1 000 (një mijë) Lekë;

Me Vendimin Nr. 01 datë 15. 06. 2005, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

1. Miratimin e llogarive vjetore të shoqërisë tregtare "ARDI-2M" SHPK, për vitin financiar 2004 (1 Janar –31 Dhjetor 2004);
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë me anë të rezervave dhe fitimeve të pashpërndara gjendje me 31 Dhjetor 2004;
3. Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar, me Nr. Liçence 97 datë 13 .12. 2000, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar të nënshkruar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31. 12. 2004;
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË.

**Ky vendim është depozituar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 27592/4 datë 07. 11. 2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.**

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar të datës 21.11. 2005 për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, gjendje të datës 31. 12. 2004, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar. Ortaku i Vetëm, gjithashtu vëren se z. Lavdimir FUSHA, në detyrën e ngarkuar nga ana e tij, ka punuar me seriozitet, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe etikën e profesionit, gjë e cila vlen për t'u admiruar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në 850 000 (teteqind e pesedhjet mijë) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 8 500 (Tete mijë e pesqind) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit themeltar të nënshkruar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

**SHOQËRIA TREGTARE  
"ARDI-2M" SHPK  
TIRANË**

---

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

**Z. Sabah SHETA**, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 8,500 (Tete mijë e pesqind) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

**V E N D O S I**

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë të datës 21. 11. 2005, përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar;
2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në 850 000 (Teteqind e pesedhjet mijë) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe rritet vetëm vlera nominale e tyre;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 1 000 (një mijë) Lekë në 8 500 (Tete mijë e pesqind) Lekë;
5. **z. Sabah SHETA**, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 8,500 (Tete mijë e pesqind) Lekë;
6. Depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

**ORTAKU I VETËM  
I SHOQËRISË TREGTARE  
"ARDI-2M" SHPK**

**Z. SABAH SHETA**  
ARDI-2M SHPK  
IMPORT-EXPORT  
KRUE ALBANIA